



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 160/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së Tendës dhe shtandit me material propagandues gjatë fushatës zgjedhore, në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa Anr. 160/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – sepse me datë 01.10.2019, rreth orës 11:20, në sheshin “Adem Jashari” në qytetin e Prishtinës, afër komunës së vjetër të Prishtinës dhe në rrugën Skënderbe, kanë vendosur një tendë me material propagandues, si dhe një shtand me foton e kandidatit nga radhët e LDK-së, Brahim Selimaj, i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 3,100.00 (tremijë njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.160/2019, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se aktivistet e LVV-së, me datë 01.10.2019, rreth orës 11:20, në sheshin “Adem Jashari” në qytetin e Prishtinës, afër komunës së vjetër të Prishtinës dhe në rrugën Skënderbe, kanë vërejtur se subjekti politik LDK, ka vendosur një TENDË me material propagandues, si dhe një shtand me foton e kandidatit nga radhët e LDK-së, Brahim Selimaj.

Paraqitësi i ankesës më tutje theksojnë se subjekti politik LDK, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatësisht nenin 33 pika b), dhe me Rregullat zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, paraqitësi i ankesës, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi për rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 02.10.2019, ka theksuar se vendosja është bërë për faktin se komunat nuk kanë arritur që, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, megjithatë në rastin konkret LDK ka reflektuar mbi këtë, duke e larguar tendën e vendosur në sheshin “Adem Jashari” në Prishtinë, dhe shtandin e kandidatit Brahim Selimaj. Më tutje subjekti politik (LDK) deklaroi se janë marrë masa përmiruese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të bazuara, për këto arsye:**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se Tenda me material propagandues dhe shtandi me posterin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, Brahim Selimaj, është vendosur në rrugë publike sheshi “Adem Jashari”, dhe Skënderbe veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*.

Duke u nisur nga gjendja faktike mbi ngritjen e tendave, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që tenda, dhe shtandi me posterin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik (LDK), është vendosur në rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti tenda, shtandi me posterin i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur në rrugë publike.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjohës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.160/2019 më datë 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.